Kronikë

Vlorë/ Me pistoletë lodër grabitën 2 kalimtarë dhe një pikë karburanti, arrestohen 2 të mitur dhe 20-vjeçari (VIDEO)

Dy të mitur dhe një 20-vjeçar janë arrestuar në Vlorë, pasi nën kërcënimin e një arme lodër kanë grabitur dy qytetarë dhe një pikë karburanti.

Redakcia
22 Prill, 09:07 | **Përditesimi: 22 Prill, 09:26**

Share

VLORË- Dy të mitur dhe një 20-vjeçar janë arrestuar në Vlorë, pasi nën kërcënimin e një arme lodër kanë grabitur dy qytetarë dhe një pikë karburanti.

Tre të rinjtë me një pistoletë lodër si silenciator në mesnatë i kanë grabitur një shumë parash dhe një aparat celular, dy kalimtarëve. Më pas me po të njëjtën armë lodër ata kanë grabitur xhiron ditore në një karburant.

Arrestimi i tyre është bërë në lagjen "10 Korriku". Në pranga ranë, A. M., 20 vjeç, një 16-vjeçar dhe një 17-vjeçar.

LEXO EDHE:
Një fundjavë plot aktivitete për të rinjtë e Sarandës

Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan një armë imituese pistoletë me silenciator, një shumë parash, portofoli dhe aparati celular, të dyshuar të vjedhura, një mjet prerës (thikë), 2 maska mjekësore dhe automjeti tip "Audi" që autorët kanë përdorur për t'u larguar nga vendi i ngjarjes.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për veprime të mëtejshme procedurale.

Sl.E./Shqiptarja.com

TAG: grabitje Vlore

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Kohë lufte, a duhet të rikthehet shërbimi i detyrueshëm ushtarak?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Reshjet e shiut në Vlorë, bllokohet qarkullimi nga përmbytja në lagjen 'Rilindja'
21 Prill, 10:59

Gjysmëmaratona në Vlorë, 1200 garues nga e gjithë bota! Në garë dhe nxënësit e shkollave
21 Prill, 10:22

Shpërndanin kanabis nëpër zona të ndryshme të Sarandës, 2 të arrestuar! Iu gjenden edhe armë e tritol në banesa
21 Prill, 10:12

Fshati mes agrumeve, Lukova ndër destinacionet më të preferuara në bregdetin jonian! Çmime më të lira se Saranda dhe Himara

Limos Didani

21 Prill, 09:10

Vlorë, lëvizte me armë me vete, arrestohet 34-vjeçari
18 Prill, 11:26

Media italiane: Eksploroni destinacionet më të mira të pushimeve në Shqipëri
17 Prill, 09:20

VIDEO/ Vatër zjarri në Nartë të Vlorës
16 Prill, 21:19

Himarë, po ndërtonte pa leje në tokën e një shtetasi tjetër në Livadh, arrestohet 38-vjeçari
15 Prill, 12:02

Sarandë, qarkullonte me doza kanabisi dhe thikë në makinë, arrestohet në flagrancë polaku 46-vjeçar
15 Prill, 11:43

Vlorë, nis plazhi, në Pyllin e Sodës digjen goma, shtëllunga tymi mbulojnë qytetin

Armand Xhelili

14 Prill, 15:07

Nis plazhi në Vlorë, operatorët turistikë ende s'janë gati: S'ka punëtorë në sektorin e hotelerisë! Mungesa edhe në Pogradec, shkak pagat e ulëta

Armand Xhelili

Armand Braho

13 Prill, 17:17

E kishte fshehur në emër të një firme ndërtimi, SPAK i sekuestron apartamentin në Lungomare të Vlorës Fatos Tushes, ish-kryebashkiak i Lushnjës
13 Prill, 12:52

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje